

VENDIM
Nr. 82, datë 14.2.2023

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM
LETRASH TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E KONEKTIVITETIT TË RRUGËVE RAJONALE
DHE LOKALE NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale në Shqipëri, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Logo **BANKA BOTËRORE**
BNRZH – IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE
Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020

XIAOQING YU
Drejtor, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

27 tetor 2022
Drejtuar: SH.S. Delina Ibrahimaj
Ministre
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, 1001, Tiranë
SHQIPËRI

E nderuar znj. Ministre,
Shqipëri - Projekti i konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale (Huaja nr. 8850- AL)
Zgjatja e datës së mbylljes

I referohemi Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”), të datës 5 qershor 2018, për Projektin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale, dhe letrës së Ministrisë së Financave të datës 13 qershor 2022, me anë të së cilës Bankës i kërkohet zgjatja me 18 muaj e datës së mbylljes së huas të ofruar të lartpërmendur të parashikuar sipas Marrëveshjes së Huas.

Kemi kënaqësinë t'iu informojmë se Banka Botërore ka caktuar datën 30 qershor 2024 si datën më të vonshme për qëllime të nenit III B.2 të skedulit 2 të Marrëveshjes së Huas.

Me respekt,
(Nënshkrimi)

Xiaoqing Yu
Drejtore rajonale për Ballkanin Perëndimor
Rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore

Për dijeni: SH.S. Belinda Balluku, ministre, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Z. Dritan Agolli, drejtor ekzekutiv, Fondi Shqipëri i Zhvillimit
Znj. Adela Xhemali, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë
Z. Matteo Bugamelli, drejtor ekzekutiv, Banka Botërore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BOKSHIT PUBLIK DHE BASHKËRENDIMIT
TË NDIHMËS SË HUAJ
DREJTORIA E BASHKËRENDIMIT DHE SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ
SEKTORI I SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ DHE MARRËVESHJEVE

Nr. 11602 Prot.

Tiranë, më 13 / 6 /2022

Lënda: Projekti Konektiviteti të rrugëve rajonale dhe lokale

ZYRËS SË BANKËS BOTËRORE
Adresa: "Dëshmorët e 4 Shkurtit", nr. 34, Tiranë

I referohem marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të Konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale. Me qëllim finalizimin e suksesshëm të aktiviteteve për t'u financuar nga kjo marrëveshje nëpërmjet kësaj shkrese ju përcjellim kërkesën e palës shqiptare si vijon:

-shtyrjen deri më 30 Qershor 2024, të datës së mbylljes të parashikuar sipas skedulit 2, seksioni 3(B.2) të Marrëveshjes së Huas.

Kjo leter së bashku me letër tuaj të përgjigjes do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese, me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit të Konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale.

Ky ndryshim hyn në fuqi pasi pala shqiptare të njoftojë Bankën Botërore për përfundimin e procedurave të brendshme.

MINISTËR

Delina Ibrahimaj
Delina Ibrahimaj